

32001R1339

RREGULLORJA E KËSHILLIT (KE) NR. 1339/2001, DATË 28 QERSHOR 2001, "PËR SHTRIRJEN E EFEKTEVE TË RREGULLORES (KE) NR. 1338/2001 PËR PËRCAKTIMIN E MASAVE TË NEVOJSHME PËR MBROJTJEN E EUROS NGA FALSIFIKIMI NË SHTETET ANËTARE QË NUK KANË MIRATUAR EURON SI MONEDHËN E TYRE TË VETME"

Gazeta Zyrtare L 181, 4.7.2001 F. 0011 – 0011

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin themelues të Komunitetit Evropian dhe në veçanti nenin 308 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit¹,

Duke pasur parasysh opinionin e Parlamentit Evropian²,

Meqë:

1. Në miratimin e Rregullores (KE) nr. 1338/2001³, Këshilli parashikonte se nenet 1 deri në 11 të saj do të kenë efekt në ato shtete anëtare që nuk kanë miratuar euron si monedhën e tyre të vetme.

2. Është e rëndësishme që euro të gëzojë të njëjtin nivel mbrojtjeje edhe në ato shtete anëtare që nuk e kanë miratuar atë dhe për këtë qëllim duhen marrë masat e nevojshme,

MIRATON KËTË RREGULLORE:

Neni 1

Zbatimi i neneve 1 deri në 11 të Rregullores (KE) nr. 1338/2001 shtrihet edhe në ato shtete anëtare që nuk e kanë miratuar euron si monedhën e tyre të vetme.

Neni 2

Kjo Rregullore hyn në fuqi në datën e botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Evropiane.

Zbatimi i saj fillon nga data 1 janar 2002. Megjithatë, ai zbatohet nga data e publikimit të tij për kartëmonedhat dhe monedhat që ende nuk janë emetuar por që synohet të emetohen.

Kjo rregullore është detyruese në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjitha shtetet anëtare.

Nënshkruar në Luksemburg, më 28 qershor 2001.

Për Këshillin

Presidenti

B. Rosengren

-
1. *Gazeta Zyrtare* 337 E, 28.11.2000, f. 264.
 2. Opinioni i dërguar më 3 maj 2001 (ende i pabotuar në *Gazetën Zyrtare*).
 3. Shih faqen 6 të kësaj *Gazete Zyrtare*.
-